



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502460/3

Tiranë ____/____/2016

Lënda : Rekomandohet kryerja e veprimeve përmbarimore konform parashikimeve të nenit 527, 581, 583, 589 593, 594 dhe 606 të K.Pr.C., në procesin e ekzekutimit të detyrimeve të vendosura sipas Titullit Ekzekutiv, Vendimit nr. 727, datë 14.07.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, dhënë në favor të P.Sh, etj.

Drejtuar : Përmbaruesit Gjyqësor Privat, Z.Lorval Petani,
Pranë Shoqërisë Përmbarimore Gjyqësore Private
"Petani Bailiff's Office" Sh.p.k.
Adresa : Lagja nr.3, Sheshi "Lirija", Qendra e Biznesit
"Best Co", Kati 7, pranë Bashkisë,

DURRËS

Për dijeni : F.S
Adresa :

DURRËS

Z. Përmbarues!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit Ferid Shehu, në të cilën ai ka prezantuar shqetësimin për mosekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 727, datë 14.07.1999 të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Durrës, për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr. 914, datë 23.09.2013, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, me objekt midis të tjerave :

*"... Detyrimin e të paditurit Seksioni i Financës pranë Këshillit të Rrethit, Durrës, t'i kthej trashëgimtarëve të trashëgimlënësit Y.M.Sh, napolona ari 800 (tetëqind), ose kundravleftën e tyre në lekë.
Shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të paditurit".*

Nga aktet e vëna në dispozicion prej përfaqësuesit ligjor të ankuesit F.Sh., konstatohet se, pranimi i kërkesës prej Shoqërisë Përmbarimore Gjyqësore Private "Petani Bailiff's

Office” Sh.p.k, për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv është kryer më datë 28.05.2013. Me pranimin e kërkesës së kreditorit, ju si përmbaues gjyqësor i çështjes, keni lajmëruar palën debitore për detyrimin e vendosur, shkresa nr.2957, datë 23.10.2013, duke i caktuar me këtë rast dhe afatin ligjor prej 10 ditësh për dorëzimin e detyrimit në të holla në mënyrë vullnetare.

Pas kalimit të afatit ligjor për dorëzimin në mënyrë vullnetare të detyrimit në të holla, kuptohet sipas Shkresës nr.142, datë 09.05.2014, të Drejtorisë së Thesarit, Durrës, se ju i jeni drejtuar asaj, duke njoftuar vendosjen e masës së sekuestrës nga ana juaj, mbi llogarinë e palës debitore, në zërin (artikullin) 602, konform Udhëzimit nr.2, datë 18.08.2011,

“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”.

Pas më shumë se një vit e gjysëm nga vendosja e sekuestrës mbi llogarinë e palës debitore, përfaqësuesi i palës kreditore, shprehet se, nuk është bërë mundur vjelja, qoftë dhe pjesërisht, e detyrimit në të holla në ngarkim të palës debitore.

Referuar parashikimit të kryer në nenin 2 të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbaimit gjyqësor”*, i ndryshuar, se :

“Shërbimi i Përmbaimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile”,

si dhe në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 527, 581, 589, 593, 594 të K.Pr.C., është përmbauesi gjyqësor subjekti që, si përfaqësues i autoritetit shtetëror, vendos masën e sekuestrës mbi kreditë e palës debitore, institucionit buxhetor, kur ato posedohen nga personi i tretë, në këtë rast nga Dega e Thesarit, Durrës, si dhe banka e nivelit të dytë. Në këtë situatë ligjore, ka qenë dhe është detyrim për ju si përmbaues gjyqësor i çështjes, që në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë nr. 727, datë 14.07.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, të kryeni procedurat e parashikuara në nenet 583, 606 të Kodit të Procedurës Civile, me rastin e mosdhënies prej personit të tretë, Dega e Thesarit, Durrës, të informacionit sipas pikave a), b) dhe c) të këtij neni, apo ndalimit prej saj të dorëzimit së kredisë palës debitore, sikurse parashikuar në nenin 581 të K.Pr.C.

Gjithashtu, z.Përmbaues, në procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ju, pala debitore si dhe personi i tretë, Dega e Thesarit, Durrës, duhet të mbani parasysh përcaktimet e kryera në Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*. Në pikën 10/b të Udhëzimit, përcaktohet se, titullari i njësisë shpenzuese(palës debitore), me rastin e vendosjes nga ana juaj të sekuestrës mbi llogarinë(kreditë) e palës debitore në thesar, kërkon degës së thesarit të kryej pagesën e shumës së detyrimit nga zërin(artikullin) 602. Më tej, pika 11 e Udhëzimit, përcakton se ;

“Nëse titullari i njësisë shpenzuese nuk paraqet kërkesën brenda afatit të parashikuar në shkronjën "b" të pikës 10, dega e thesarit vendos masën e sekuestrës në shpenzimet operative (artikulli buxhetor 602) të njësisë shpenzuese, në masën e vendimit gjyqësor të formës së prerë, por pa prekur shpenzimet e detyrueshme për funksionimin e

institucionit, si: energji, ujë dhe materiale e shërbime speciale (artikulli 6021), të përshkruara në Manualin e Shpenzimeve Publike, të publikuara nga Ministri i Financave”.

Fakti që, me shkresën nr.142, datë 09.05.2014, Drejtoria e Thesarit, Durrës, ka konfirmuar marrjen dijeni të vendosjes së sekuestrës nga ana juaj, mbi llogarinë(zërin, artikullin 602) të palës debitore, detyron personin e tretë (Dega e Thesarit, Durrës), si dhe ju z.Përmbarues, që të kryeni veprime për ekzekutimin e detyrimit në të holla, në favor të palës kreditore, sikundër parashikuar në nenin 581, 583, 589, 594, 598, 606 të K.Pr.C.

Procedurat e parashikuara në dispozitat e lartpërmendura, rezultojnë të pakryera në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr. 727, datë 14.07.1999, të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, Durrës.

Ky qëndrim ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit.

Për arsytet e bërë të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, i cili parashikon se : *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË

Kryerjen e veprimeve përmbarimore sikurse parashikuar në nenin 527, 581, 583, 589, 593, 594 dhe 606 të K.Pr.C. për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit nr.727, datë 14.07.1999, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

Konceptoi dhe Datilografoi
A.Gjoleka

